


TRAJNIM

“Monitorimi i standarteve të Konventës CEDAë dhe Konventës së Stambollit nga organizatat jofitimprurëse si dhe roli i tyre në procesin e Rishikimit Periodik Universal të standarteve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave”.


19–20 Mars 2018




PREZANTIMI DHE OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

- ▶ Prezantim i pjesëmarrësve:
 - ▶ – Emri/ organizata
 - ▶ –Si është e lidhur organizata juaj me mbrojtjen e dhunës me bazë gjinore?
- ▶ Pse jeni të interesuar në trajnimin mbi monitorimin e standarteve të cedaw? Cilat janë qëllimet tuaja për këtë trajnim dhe si cfarë doni të kuptoni më mirë?
- ▶ Agjenda


OBJEKTIVAT

- ▶ Forcimi i aftësive praktike të OJF–ve në lidhje me monitorimin e standarteve të konventës CEDAë.
 - ▶ Familjarizimi me konceptet kyc të monitorimit dhe ndryshimi i tyre nga vlerësimi;
 - ▶ Hartimi i qëllimeve dhe objektivave të monitorimit;
 - ▶ Identifikimi i kriterëve për përzgjedhjen e treguesve të monitorimit dhe burimet e informacionit;
- 

Si arrihen objektivat?

- ▶ Bazohet në mësimin universal nga i gjithë grupi.
 - ▶ Pjesëmarrësit sjelli informacion dhe eksperiencë të rëndësishme ;
 - ▶ Pjesëmarrësit të lirë të ndajnë eksperiencat e tyre në lidhje me monitorimin.
- 

USHTRIM 1

- ▶ Cilat janë pritshmëritë tuaja nga ky trajnim?
 - ▶ Cfarë aftësish keni/ cila është eksperiencia juaj në lidhje me monitorimin?
 - ▶ Cfarë planesh keni pas trajnimit?
- 

Fazat e monitorimit

- ▶ Monitorim i zbatimit të detyrimeve të Konventës CEDAë (roli i OJF)
- ▶ Monitorim i zbatimit të Rekomandimeve të Komitetit pas rishikimit të shtetit në sesionin e mëparshëm të Komitetit.
(rekomandimet që gjenden në vërejtjet përmbyllëse)

Procesi i monitorimit

- ▶ Përpara se të iniciojmë procesin e monitorimit duhet të njihen detyrimet që ka pasur shteti për të përmbushur në përputhje me standartet e Konventës CEDAë.
- ▶ Dhuna me bazë gjinore : Pjesë e RP 12,19,35
 - Në fushën legjislative
 - Në fushën administrative/ ekzekutive
 - Në fushën gjyqësore

MONITORIMI VS VLERËSIMI

► Ushtrim nr.3:

Cili është ndryshimi midis monitorimit dhe vlerësimit?

Bëni një listë se cfarë përfshin monitorimi?
Cfarë iu vjen në mend kur mendoni monitorimin?

Bëni një listë se cfarë përfshin vlerësimi?

Ku ndryshojnë ata me njëri tjetrin?

Si lidhet monitorimi me vlerësimin?

A bëjnë OJF vlerësim?



Monitorimi = Ndjekja e ndryshimeve në lidhje me plotësimin e detyrimeve të shtetit, ndryshimet në performancë.

- ▶ Monitorimi: proces i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave në lidhje me treguesit.
- ▶ Shpesh referohet si një proces vlerësimi.

Vlerësimi = Vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur ; Vlerësimi i masës në të cilën aktorët e ndryshëm janë përgjegjës për ndryshimet e vërejtura.

Bëhet mbi bazën e studimeve kërkimore.

- ▶ Monitormi dhe vlerësimi janë anë të së njëjtës medalje.
- ▶ Nevojitet të dyja për të sjellë rekomandime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e situatës.
- ▶ Të dyja ndihmojnë për të matur efektivitetin e masave të marra.
- ▶ është monitorim apo vlerësim?
 1. Nqs duam të dimë nëse ngritja e programeve të këshillimit ndihmon në reduktimin e dhbgj.
 2. Nqs duam të dimë se sa viktimat të dhunës në familje kanë përfituar nga programet e ndihmës juridike.
 3. Nëse duam të dimë nëse programet e ofruara nga shteti për të mbështetur viktimat e dhbgj plotësojnë standartet ndërkombëtare. (monit.cilësinë)

Programet e monitorimit të DHBGJ

- ▶ Kryesisht brenda 4 kategorive:
 1. Mobilizimi i komunitetit (për të adresuar DHBGJ brenda programeve të tyre)
 2. Ndryshimi i sjelljes së publikut (sfidojnë normat e sjelljes që pranojnë dhtgj/ rritin ndërgjegjësimin e publikut)
 3. Ligj dhe politika publike (standartet e përputhjes së ligjit kombëtar me Konventën)
 4. Shpërndarja e shërbimeve (identifiko rastet e dhtgj në mbrojtje të viktimave të dhunës. A ofrohen shërbimet e duhura?

Monitorimi bazohet tek Konventa/ Vërejtje Përmbyllëse dhe Rekomandime të Komitetit.

Ushtrim Nr.2

- ▶ Sfidat në lidhje me monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar mbi CEDAë.


Sfidat e Monitorimit

- ▶ Procesi i monitorimit mund të shoqërohet me sfida të OJF për kryerjen me efikasitet:
 - Ngritja e kapaciteteve;
 - Burimet materiale;
 - Mbledhja e të dhënave;
 - Natyra sensitive e informacionit dhe fshehja e të dhënave;
 - Mungesa e përkufizimeve të standartizuara të dëgjimit dhe treguesve ;
 - Cështje etike.
- 

Procesi i monitorimit:

- ▶ Tre faza kryesore:
 - ❑ Përcaktimi i objektivave të monitorimit
 - ❑ Krijimi i kornizës / Kuadrit të monitorimit
 - ❑ Përcaktimi i treguesve
 - ❑ Matja dhe analiza e të dhënave

Objektivat e monitorimit

- ▶ Organizatat hartojnë planet e tyre të monitorimit:
 - ▶ Përcaktojnë qëllimin dhe objektivat e monitorimit.
 - ▶ Objektivat : SMART (Specifike, të matshme, të përshtatshme, realiste, të lidhura me kohën)
 - ▶ Objektiva : action oriented (i drejtohen pyetjeve cfarë, kush, sa, kur por jo pse dhe si?
- 


Treguesit e monitorimit

- ▶ Treguesit janë karakteristika specifike, të vëzhgueshme dhe të matshme që mund të përdoret për të treguar progresin që po bën shteti në arritjen e një rezultati specifik. Nëpërmjet treguesve ju kërkoni të monitoroni se si shteti po përparon drejt arritjes së objektivave tuaja. Me fjalë të tjera, treguesit janë të dhëna që tregojnë sa afër jemi për të arritur objektivat tona dhe se sa kanë ndryshuar gjërat në krahasim me periudhat e mëparshme.

Karakteristikat e treguesve

- ▶ Që një tregues të jetë i sa më i përshtatshëm ai duhet të plotësojë disa karakteristika:
 - ▶ Të jetë i matshëm: kur mat në mënyrë të saktë objektivat e monitorimit.
 - ▶ Të jetë i besueshëm: kur minimizon gabimin e matjes, dmth kur është e mundur të matet vazhdimisht një tregues me kalimin e kohës pavarësisht vëzhguesit ose të intervistuarit.
 - ▶ Të jetë preciz: i saktë, i mirëpërcaktuar, specifik.
 - ▶ Të lidhur me kohën, i arritshëm brenda një periudhe kohe: Duhet të matë arritjen e objektivave brenda një periudhe të caktuar monitorimi.
 - ▶ Të lidhur me objektivat e monitorimit.
- 


Treguesit metrike

- ▶ Treguesit matin ndryshimin, nuk tregojnë drejtimin e ndryshimit. (rritja e përqindjes së viktimave të dhbgj që kanë përfituar nga programet e strehimit vs përqëndja e viktimave..)
 - ▶ Mund të hartohen në disa forma:
 - ▶ Numri i viktimave të dhunës që kanë përfituar ndihmë ligjore falas;
 - ▶ Përqindja e ankesave të dhunës me bazë gjinore të trajtuara nga gjykata;
 - ▶ Prezenca ose jo e ligjeve, praktikave në përputhje me standartet e cedaë.
- 


Sa tregues janë mjaftueshëm për monitorimin?

- ▶ Një nga pyetjet që shqetësojnë organizatat sot është se sa tregues duhet të hartojnë që të matin sa më mirë rezultatet.
 - ▶ Varet nga objekti i monitorimit, jo shumë tregues.
 - ▶ Të paktën 1 / 2 tregues për cdo objektivë.
 - ▶ Përdorni një shumëllojshmëri të dhënash për vlerësimin e treguesve.
 - ▶ Të dhëna sasiore (mat trendin e ndryshimit)
 - ▶ Të dhëna cilësore (tregon kontekstin se si ka ndodhur ndryshimi)
- 


Llojet e të dhënave të mbledhura

- ▶ Të dhëna të marra nga dokumentet zyrtare;
 - ▶ Të dhëna të prodhuara si rezultat i studimeve të kryera nga kërkues të pavarur ose nga universitetet;
 - ▶ Të dhëna të marra nga organizata ndërkombëtare ose nga OJF ndërkombëtare;
 - ▶ Të dhëna të prodhuara nga vetë OJF-të si rezultat i kërkimeve të kryera prej tyre ose aktivitetit të tyre
- 

Sfidat e zgjedhjes së treguesve:

- ▶ Zgjedhja e një treguesi që nuk lidhet me rekomandimet
 - ▶ Zgjedhja e një treguesi jo shumë të qartë, që mund të jetë objekt interpretimi
 - ▶ Zgjedhja e treguesve që nuk mund të mblidhen (nuk ka të dhëna)
 - ▶ Përcaktimi i shumë indikatorëve në të njëjtën kohë.
- 

Zgjedhja e treguesve të monitorimit

- ▶ Treguesit duhet të jenë të:
 - ▶ Të lidhur me detyrimet që duhet të plotësohen, rekomandimet
 - ▶ Të dhënat që janë të mundshme për t'u mbledhur
 - ▶ Resurset
 - ▶ Indikatorët standarte
- 

Detyrimet e shtetit nga RP nr.35 i Komitetit

- ▶ Në nivel **legjislativ** shteteve u kërkohet që të miratojnë një kuadër ligjor efektiv që ndalon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave duke harmonizuar ligjin e brendshëm me Konventën.

Treguesit:

- ▶ A ofron legjislacioni në fuqi mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore?
- ▶ Në se po, për cilat forma të dhunës me bazë gjinore, legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtje? A është përkufizimi i diskriminimit sipas ligjit shqiptar në përputhje me parashikimet e Konventës? A e përfshin përkufizimi i diskriminimit dhunën me bazë gjinore?
- ▶ A përmban ligji shqiptar dispozita të ndjeshme nga pikëpamja gjinore?
- ▶ A janë të parashikuara në ligj sanksionet dhe dëmshpërblimi i grave në rastet e dhunës ndaj tyre?
- ▶ A janë të aksesueshëm nga gratë ligjet që adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe a ka të dhëna në lidhje me aksesin e tyre në këto ligje?etj


- ▶ Në nivel **ekzekutiv** shtetet palë janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e mekanizmave të monitorimit të dhunës me bazë gjinore, për krijimin e shërbimeve të aksesueshme dhe të përballueshme për viktimat e dhunës, për eliminimin e praktikave institucionale që rezultojnë në dhunë me bazë gjinore etj.

Tregues:

- ▶ A ka ngritur qeveria shqiptare mekanizma të monitorimit të dhunës me bazë gjinore? A ka planifikuar për këto mekanizma buxhet të mjaftueshëm?
- ▶ A buxhetohet në buxhetin e shtetit dhuna me bazë gjinore? Po në nivel lokal
- ▶ A garanton shteti shqiptar ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje? A ofrohet shërbim ligjor falas për to edhe në nivel lokal?
- ▶ A ka mjaftueshëm strehëza dhe shërbime të tjera mjekësore dhe sociale për të rehabilituar gratë viktimat të dhunës?
- ▶ A ka shteti programe rehabilitimi për viktimat e dhunës me bazë gjinore?
- ▶ Çfarë masash ka marrë qeveria për të parandaluar ngacmimin seksual?
- ▶ A janë të ngritura linjat e këshillimit për viktimat e dhunës në të gjithë territorin? Si funksionojnë ato? A janë të aksesueshme 24/7?

Në nivel **gjyqësor**, të gjitha organet gjyqësore janë të detyruara të mos përfshihen në asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit ose dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe të zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha dispozitat e ligjit penal që ndëshkojnë këtë dhunë, duke siguruar që të gjitha procedurat ligjore në rastet që përfshijnë raportimet për dhunë me bazë gjinore kundër grave janë të paanshme, të drejta dhe të pandikuara nga stereotipet gjinore ose interpretimi diskriminues i dispozitave ligjore.

Tregues:

- Çfarë vendimesh janë marrë nga gjykatat në lidhje me dhunën në familje? Sa urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm Mbrojtje janë lëshuar nga Gjykata, gjatë periudhës objekt monitorimi?
 - Sa efektive kanë qenë UM dhe UMM? Cila është shkalla e zbatimit të tyre? A janë marre masa në rast moszbatimi?
 - A përmbajnë vendimet e gjyqtarëve referime të Konventës CEDAë dhe rekomandimeve të përgjithshme të saj?
 - Si i trajtojnë policia dhe autoritetet gjyqësore gratë që raportojnë dhunën seksuale dhe i drejtohen gjykatës?
 - A janë procedurat e ankimimit të thjeshta, të aksesueshme dhe të shpejta për viktimat e dhunës me bazë gjinore?
- 

VP dhe objekti i monitorimit.

- ▶ **REKOMANDIM Nr.13 (b)** : Të marrë masa për forcimin e autoritetit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore parësore ose dytësore duke përfshirë këtu edhe ngritjen e klinikave ligjore vendore të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike;
- ▶ **REKOMANDIM Nr.23 (a)** : Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh;
- ▶ **REKOMANDIM Nr.13 (d)** : Të ndryshojë barrën e provës në rastet e pretenduara për diskriminim mbi bazë seksi ose me bazë gjinore në favor të ankuesve
- ▶ **REKOMANDIM Nr.23 (d)**: Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor, si përmbaruesit gjyqësorë.